



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Në pajtim me Programën për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2016 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 2/2016), Ministria e Ekonomisë shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për kofinansim të projekteve të odave të zejtarëve dhe esnafëve për zhvillim dhe promovim të zejtarisë në Republikën e Maqedonisë

1.Lëndë e thirrjes publike është kofinansimi i projekteve të odave të zejtarëve dhe esnafëve të cilat i referohen zhvillimit dhe promovimit të zejtarisë në Republikën e Maqedonisë, respektivisht përkrahje financiare të projekteve për:

- organizim të trajnimeve;
- organizim të forumeve;
- shërbime konsultative;
- aktivitete promotive (organizim të panairove dhe manifestimeve).

Në pajtim me Programën për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2016 pjesa II, A-Përkrahje dhe zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Masa 1.2. Kofinansim të projekteve të odave të zejtarëve dhe esnafëve për zhvillim dhe promovim të zejtarisë në Republikën e Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.2/2016) janë paraparë mjete në vlerë të përgjithshme prej 910.000 denarë.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë Odat e zejtarëve të regjistruara në pajtim me Ligjin për kryerjen e veprimtarisë zejtare („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/2004; 55/2007; 115/2010; 36/2011 53/2011, 164/2013 и 129/2015), esnafët dhe shoqatat qytetare të regjistruara në zhvillim të tërë, përkrahje dhe promovim të zejtarisë të regjistruara në bazë të Ligjit për shoqatat dhe fondacionet („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52/10, 135/11).

3. Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Formulari „Kërkesë – KP ZK 2016”;
- Formulari „Proekt – KP ZK 2016”;
- Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendror, jo më e vjetër se 3 (tre) muaj ;

- Vërtetim për tatime dhe kontribute të paguara nga Drejtoria e të Hyrave Publike, jo më i vjetër se 3 (tre) muaj;
- Deklaratë që me projektin me të cilin aplikon deri tani nuk ka shfrytëzuar mjete nga Buxheti i RM-së ose nga donatorë të huaj, e vërtetuar te noteri.
- Fletpagesë me vlerë prej 300,00 denarë (Qëllimi i pagesës: pagesë për taksa administrative, Pranues: Buxheti i RM, Llogaria e trezorit: 100000000063095, Llogaria: 840___ (varësisht nga komuna) 06116, Kodi i të hyrave dhe programa: 72593000)

Dokumentacioni i lartpërmendur dorëzohet në origjinal apo kopje.

Nëse dokumentacioni dorëzohet kopje, besueshmërinë e e dokumentacionit aplikuesi i kërkesës e vërteton me nënshkrim dhe vulë të vetën në secilën faqe të kërkesës.

Formularët „Kërkesë – KP ZK 2016” dhe „Projekt – KP ZK 2016” për paraqitje në thirrjen publike, aplikuesit mund ti marrin në arkivën ose ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk si dhe në portalin www.konkurentnost.mk

4. Kriteret për vlerësim të projekteve:

1. Projekti – 60 pikë
2. Biografia e punës së personave që do të jenë të angazhuar në realizim të projektit – 30 pikë
3. Lista referuese e projekteve – 10 pikë

Një aplikues mund të aplikojë vetëm me një projekt për këtë thirrje publike.

Nuk kanë të drejtë për pjesëmarrje aplikuesit kundrejt të cilëve Ministria e ekonomisë udhëheq procedurë për shfrytëzim joqëllimor të mjeteve të dhëna për këtë qëllim në vitet paraprake.

Vlera maksimale për kofinansim të shpenzimeve për projekt është 150.000 denarë.

Shpenzimet për reprezentacion (drekë, koktej), llogaritë për shërbime komunale (rrymë, ujë, nxemje) telefon dhe internet nuk do të jenë lëndë kofinansimi.

Kërkesat për kofinansim të projekteve i shqyrton Komisioni i formuar nga Ministri i Ekonomisë.

Kërkesat për kofinansim të projekteve me dokumentacionin e kompletuar dorëzohen në Arkivën e Ministrisë së Ekonomisë, rr. “Jurij Gagarin” nr. 15, Shkup, deri më 09.08.2016.

tel: (02) 3093 445; (02) 3093 431 www.economy.gov.mk

